

Edhe përballë sulmeve islamofobike, muslimanët asnjëherë nuk do të gjunjzohen, tha presidenti i Turqisë Recep Tayyip Erdo?an pas sulmeve terroriste ndaj xhamive në Zelandën e Re, nga të cilat 49 persona humbën jetën, raporton Anadolu Agency (AA).

"Si muslimanë, kurrë nuk gjunjzohemi dhe nuk do të biem në nivelin e këtyre frikacakëve", tha Erdo?an në një tubim në provincën juglindore Gaziantep.

Komentet e presidentit turk erdhën pas sulmeve ndaj besimtarëve në dy xhami në qytetin Christchurch të Zelandës së Re, të cilat gjithashtu lanë 48 persona të plagosur, përfshirë tre qytetarë turq.

"Ky vrasës lëshoi një deklaratë kundër vendit tonë, kombit tonë, personalitetit tim dhe të gjithë muslimanëve", shtoi ai, duke iu referuar një manifesti në internet të postuar nga njëri prej të dyshuarve në masakër.

Erdo?an shtoi se Turqia do të shfaqë të njëjtin qëndrim parimor ndaj vdekjes së çdo njeriu të pafajshëm, pavarësisht nga origjina dhe besimi i tij.